



PJESËMARRJA E QYTETARËVE NË REALIZIMIN E VETËQEVERISJES LOKALE (Komuna e Ulqinit)

Hulumtím i opínionít publik

SHËNIME HYRËSE

Anketa me qytetarë, rezultatet e së cilës po i paraqesim në këtë broshurë, është pjesë e projektit “QYTETARËT INFORMOHEN - QYTETARËT PARTICIPOJNË” të cilin e realizon organizata e shoqërisë civile “Horizonti I Ri” me mbështetjen e Fondit Ballkanik për Demokraci .

Ky projekt paraqet vazhdimin e aktiviteteve dhe angazhimit shumëvjeçar të organizatës sonë, të cilat kanë për qëllim promovimin e konceptit të qeverisjes së mirë lokale dhe sensibilizimin e qytetarëve për pjesëmarrje në proceset vendimmarrëse të Komunës së Ulqinit.

Qëllim i veçantë i këtij projekti është: *rikthimi i besimit të qytetarëve në organet e vetëqeverisjes lokale, si dhe informimi dhe fuqizimi i qytetarëve për pjesëmarrje aktive në zgjidhjen e problemeve të komunitetit lokal.*

Projekti synon edhe rritjen e vetëdijes qytetare për pjesëmarrje më të madhe në jetën politike të komunës së Ulqinit, krijimin e kushteve për pjesëmarrje më aktive të qytetarëve, si dhe të iniciojë e ndihmojë miratimin e strategjisë për pjesëmarrjen e qytetarëve në jetën publike lokale.

Aktiviteti kryesor i këtij projekti - anketimi i opinionit publik, që u realizua gjatë periudhës gushtator 2011, është zhvilluar në dy mënyrë.

Për herë të parë, ne përdorëm mundësitë që ofron interneti për realizimin e anketimeve publike. Në një prej platformave të shumta që ofrojnë programe për anketim (www.surveymshare.com) si dhe në web-sajtin e organizatës tonë (www.ngo-horizonti.org), ne vendosëm formularin e anketës, identik me atë që përdorëm në terren dhe pastaj, përmes kanaleve të përshtatshme për komunikim (Facebook, listat e e-maileve, forumet,...), ne e lançuam këtë proces. Anketa që gjendej në formë elektronike, ofroi anonimitet të plotë për publikun e interesuar, ndërsa mundësitë e keqpërdorimeve ishin minimale.

Mënyra tjetër në të cilën u zhvillua kjo anketë, ishte ajo që ne e përdorim tradicionalisht – anketimi në terren me anketues të trajnuar. Në këtë formë u realizua rreth 60% e anketimit.

Qytetarët janë anketuar në rrugë, në vendet e punës, në ambiente private, etj...dhe aktivistët tanë janë kujdesur për respektimin e karakteristikave të komunitetit lokal (*përfshirja territoriale, gjinore nacionale, etj.*).

Pyetësi ka qenë i hartuar nga 13 pyetje në të cilat janë përgjigjur gjithsej 204 qytetarë.

I terë materiali i përdorur në procesin e anketimit ka qenë dygjuhësh (shqipe dhe malazeze).

Përveç paraqitjes së gjendjes aktuale dhe identifikimit të mundësive për fuqizimin e pjesëmarrjes qytetare në nivelin lokal, ky publikim ka për qëllim të ndihmojë edhe nxitjen e dialogut në mes të palëve të interesuara në komunitetin lokal.

Kjo është hera e tretë që OJQ “Horizonti I Ri” realizon hulumtim të opinionit publik lidhur me punën Administratës të Komunës së Ulqinit, procesin e reformimit të vetëqeverisjes lokale si dhe implementimin e ligjeve përkatëse dhe rregulloreve komunale.

Rekomandimet të cilat ndodhen në fund të këtij publikimi paraqesin bazë të mirë për ndërtimin e një strategjie efikase për forcimin e pjesëmarrjes qytetare në procesin e hartimit, miratimit dhe implementimit të politikave publike në komunën e Ulqinit.




Grupi punues:

Nazif Veliqi, Allmir Çaushti, Mustaf Canka, mr Dritan Abazović, Flutur Mustafa, Nikolla Popović



1 Sa jeni ju personalisht i interesuar për atë që ndodhë në komunitetin lokal?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Shumë i interesuar	88
Kryesisht i interesuar	62
Kryesisht i paineresuar	28
Krejtësisht i paineresuar	26
	204



Që qytetarët tonë janë të interesuar për ngjarjet në komunitet, tregon edhe rezultati se gati 3/4 e të anketuarve janë shumë ose kryesisht të interesuar për atë se çfarë ndodhë në komunën e Ulqinit (43% shumë të interesuar dhe 30% kryesisht të interesuar).

Përqindja e atyre që janë më pak të interesuar ose që janë krejtësisht të paineresuar për ngjarjet në komunitetin lokal, arrin në 27% të të anketuarve (14% kryesisht të paineresuar dhe 13% krejtësisht të paineresuar).


Rezultatet tregojnë se tri të katrat e qytetarëve janë të interesuar për zhvillimet në komunitetin lokal. Por megjithatë, një analizë më e hollësishme do të tregonte se përse 27% e qytetarëve janë të paineresuar për atë që ndodhë në komunën e tyre. Për këtë, pushteti lokal duhet të angazhohet më shumë dhe t'i sigurojë qytetarët që komuna është themel i demokracisë lokale dhe se në të vërehet fuqia e gjithë qytetarëve të saj.

"Vetëqeverisja lokale përfshinë të drejtën e qytetarëve dhe të organeve të vetëqeverisjes lokale, që të rregullojnë dhe administrojnë punët e caktuara publike dhe të tjera, nën përgjegjësinë e tyre dhe në interes të popullatës lokale" (neni 1 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale);

"Në komunë realizohet përbushja e nevojave me interes të drejtpërdrejt dhe të përbashkët për popullatën lokale" (neni 4 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale).

2 Pa marrë parasysh interesimin tuaj, sa jeni ju i informuar për aktivitetet (me interes të përbashkët) që ndërmerret Komuna jonë?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Plotësisht i informuar	8
Kryesisht i informuar	85
Kryesisht i painformuar	67
I painformuar	44
	204




Më pak se gjysma e qytetarëve të anketuar (42%) konsideron se është kryesisht e informuar për aktivitetet që ndërmerret Komuna (e që iu përkasin qytetarëve), ndërsa një numër i vogël i tyre pohon se është plotësisht i informuar. Shumica e të anketuarve është deklaruar si pjesërisht apo krejtësisht e painformuar për aktivitetet e Komunës (33% kryesisht të painformuar dhe 21% plotësisht të painformuar).

3 Nëse nuk jeni i informuar, cilat janë arsyet?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Nuk jepen informata	83
Nuk kam kohë	11
Nuk jam i interesuar	13
Diçka tjetër*	4
	111

Në këtë pyetje janë përgjigjur vetëm ata që janë deklaruar "kryesisht ose plotësisht të painformuar" në pyetjen 2.



* Mungon përgjegjësia dhe transparencja në punën e tyre

* Jotransparenca e ekzekutivit - centralizim lokal dhe individual !

Ndër arsyet më të shpeshta të mosinformimit, qytetarët kanë theksuar mungesën e informacionit për punën e Komunës (75%). Një numër i vogël prej tyre shprehë mosinteresimin personal (12%) dhe mungesën e kohës (10%), si shkak për mosinformim për aktivitete të Komunës.

Pra, në 3/4 e përgjigjeve në këtë pyetje qytetarët shprehin brengosje për (jo)transparencën në punën e vetëqeverisjes lokale, respektivisht për "largim" nga qytetarët dhe komuniteti lokal.

"Organet e vetëqeverisjes lokale janë të obliguar që qytetarëve t'iu japin të dhënat, sqarimet dhe njoftimet e nevojshme, për realizimin e të drejtave dhe interesave të tyre.


Dhënia e njoftimeve realizohet edhe përmes mjeteve teknike, broshurave dhe mjeteve të informimit publik.

Për mënyrën e veprimit në çështjet administrative, organet e qeverisjes vendore janë të obliguar t'i publikojnë procedurat e veprimit".(neni 112 i Ligjit për vetëqeverisjen lokale).

4 Nga cilat burime informoheni kur dëshironi të dini se çfarë ndodhë në Komunën tonë?

përgjigjet e qytetarëve	nr. i përgjigj.	të anketuar
Gazetat	75	35
Televizioni lokal	119	56
Shërbimet përkatëse të Komunës	9	4
Interneti	85	40
Asnjë (nuk jam i interesuar)	13	6
Fqinjët, miqtë	29	14
Radiot lokale	11	5
Takimet, tribunat, debatet publike	22	10
Nga politikanët lokal	70	33
Diçka tjetër	0	-
	433	204

Në këtë pyetje qytetarët patën mundësi të rrumbullakojnë më disa përgjigje



68% e të anketuarve veçojnë mediat dhe internetin si mjetet kryesore të informimit të qytetarëve për aktivitetet e Komunës (27% e tyre informohen përmes Televizionit lokal, 17% përmes gazetave, vetëm 3% përmes radiove lokale, ndërsa përmes internetit informohen 20% e të anketuarve).


Nga politikanët lokal informohen 16% e qytetarëve të anketuar, ndërsa vetëm 7% e qytetarëve përfitojnë (informacione) nga komunikimi me miqtë apo fqinjët e vet.

Nga debatet publike informohen vetëm 5% e qytetarëve, kurse më e madhe është përqindja e atyre që nuk janë fare të interesuar (3%) se e atyre që informohen përmes shërbimeve të Komunës (2%).

Fakti që gati 70% e qytetarëve informohen përmes mediave, rekomandon që mbështetja (financiare) ndaj tyre duhet të jetë më e madhe, por edhe në shërbimet për marrëdhënie me publikun.

5 A keni marrë pjesë (në 3 vitet e fundit) në aktivitete siç janë INICIATIVAT QYTETARE?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
PO	47
JO	157
	204




Se sa i ulët është niveli i informimit dhe i veprimit të qytetarëve për të marrë pjesë në aktivitetet komunale, tregon e dhëna që 77% e të anketuarve nuk kanë qenë asnjëherë pjesëmarrës të iniciativave qytetare, në tri vitet e fundit.

Vetëm 23% e qytetarëve të anketuar ka marrë pjesë në iniciativa qytetare.

Ekziston pra një potencial i madh (77% e qytetarëve) për të përhapur "qytetarinë vepruese". Këtë patjetër duhet ta shfrytëzojë politika lokale dhe shoqëria civile.

6 A keni nënshkruar ndonjë PETICION?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Njëherë	57
Disa herë	65
Asnjëherë	82
	204




Angazhimi i qytetarëve në nënshkrimin e peticioneve është dukshëm më i lartë se sa kur bëhet fjalë për iniciativat qytetare. Shumica e të anketuarve së paku njëherë ka nënshkruar peticion, e në kuadër të këtij numri, më shumë janë ata të cilët disa herë e kanë kryer këtë akt (28% kanë nënshkruar vetëm njëherë peticion, kurse 32% disa herë).

Megjithatë, mbetet shqetësues numri i qytetarëve pasiv (40%) të cilët asnjëherë nuk kanë nënshkruar asnjë peticion.

Krahasuar me komunat tjera, këto të dhëna janë inkurajuese. Gjithsesi kjo tregon rritje të vetëdijes qytetare, si rezultat i fushatave të suksesshme që kanë ndërmarrë shoqatat e qytetarëve dhe subjektet politike.

7 A keni folur ndonjëherë publikisht në ndonjë tubim, konferencë apo takim?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Njëherë	26
Disa herë	56
Asnjëherë	122
	204




Vërtetë është shqetësues fakti se sa qytetarët tanë janë të gatshëm të dalin përpara bashkëqytetarëve tjerë dhe të shprehin mendimin e vet, pra sa janë aktiv në tubimet në të cilët marrin pjesë. Me fjalë tjera, 60% e qytetarëve të anketuar, asnjëherë nuk kanë folur para publikut të gjerë, qoftë ajo një tubim, mbledhje apo konferencë. Vetëm 27% e qytetarëve ka diskutuar në takime publike, kurse 13% e tyre vetëm njëherë e kanë bërë këtë.

Vetëm atëherë kur ata të cilët kanë nënshkruar peticione, të konfirmojnë angazhimin e vet në aksione konkrete, mund të konkludojmë se "guximi qytetar" në Ulqin është poashtu në rritje.

8 Për çfarë çështjeve do të dëshironit që Komuna (Qeverisja vendore) t'ju konsultonte – të merrte mendimin tuaj?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Infrastruktura (rrugët, ndriçimi, rregullimi i qytetit,)	45
Problemet komunale (parkingjet, komunikacioni, tregu, plehrat)	51
Ujësjetllësi, kanalizimi, mbrojtja e ambientit	42
Problemet e të rinjve	47
Avancimi i bujqësisë	15
Nuk dëshiroj të më konsultojnë	1
Diçka tjetër *	3
	204



- * Çështjet e kulturës, reforma e arsimit
- * Profesionalizimi i kuadrove të Komunës
- * Hapja e Qendrës për rehabilitim (nga sëmundjet e varësisë)

Rezultatet tregojnë se qytetarët do të dëshironin të konsultoheshin dhe të jepnin kontributin e vet në fusha të ndryshme të jetës së komunitetit lokal. Një e katra e e të anketuarve do të dëshironte të konsultoheshin për problemet komunale (parkingjet, komunikacioni, tregu, plehrat,...), ndërsa afërsisht i njëjti numër do të dëshironte të konsultoheshin për çështjet rrugëve, ndriçimit, rregullimi të qytetit në përgjithësi (22%). Për zgjidhjen e problemeve të ujësjetllësit, kanalizimit dhe mbrojtjes së ambientit, dëshirojnë të konsultohen 21% e qytetarëve, ndërsa 23% e qytetarëve është e brengosur për problemet e të rinjve dhe aty dëshirojnë të kontribuojnë.


Numri i atyre që nuk dëshirojnë të konsultohen është fare simbolik (1%), sikurse edhe numri i atyre që do të dëshironin të konsultoheshin për disa çështje tjera (për problemet në fushën e kulturës, arsimit, luftën kundër narkomanisë, etj.)..

Pra, qytetarët janë deklaruar për ato probleme/fusha të cilët i shqetësojnë dhe për të cilët mendojnë se i njohin më së miri. Prandaj, konsiderojmë se këto rezultate mund të shërbej ë si një "udhëzues" i mirë për krijimin e politikave

M y

9 A merrni pjesë (ju personalisht) në tubimet që organizon Komuna me qytetarë?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Nganjëherë	79
Shpesh	28
Asnjëherë	55
Nuk di për takime të tilla	42
	204




Duke mos specifikuar se në çfarë tubimesh që organizon Komuna qytetarët marrin pjesë, shumica e të anketuarve participon në to. Shpesh në këto tubime marrin pjesë 14% e të anketuarve, ndërsa nganjëherë këto aktivitete i ndjekin 39% e tyre. Më shumë se një e katra e të anketuarve asnjëherë nuk ka marrë pjesë në tubime të tilla, ndërsa 20% e të anketuarve nuk ka fare informacion për organizimin e këtyre aktiviteteve.

Gati gjysma e qytetarëve nuk merr pjesë në tubimet me qytetarë, të cilët për çështje të ndryshme i organizon pushteti lokal. Zakonisht në këto takime shihen të njëjtit persona (14%), prandaj edhe në këtë aspekt duhet të rritet niveli i informimit të publikut dhe të zgjidhen tema sa më interesante.

Qytetarëve patjetër që duhet t'u jepen edhe informata kthyesë (përgjigje, sqarime,) në propozimet dhe sugjerimet që ata kanë shprehur. Kjo (sigurisht) që do t'i motivojë për participuar edhe në takime tjera të ngjashme.

10 Nëse nuk merrni pjesë, cilat janë arsyet? (për ata që nuk marrin pjesë, nga pyetja e mëparshme)

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Nuk jam i informuar	36
Nuk kam kohë për aktivitete të tilla	5
Mendimi i qytetarëve nuk mund të ndryshojë as	42
Nuk di për takime të tilla	13
Diçka tjetër	1
	97




Ndër arsyet që më së shumti përmendin qytetarët për mospjesëmarrje në takimet publike (që organizon pushteti lokal), theksohet bindja e tyre se ata nuk mund të ndryshojnë asgjë (43% e atyre që nuk marrin pjesë). Ndërkaq, 37% e tyre nuk janë të informuar edhe pse do të merrnin pjesë në këto aktivitete. Nga të anketuarit që nuk marrin pjesë në takimet publike të Komunës, 14% e tyre nuk di aspak për takime të tilla, kurse 5% nuk kanë kohë për aktivitete të tilla.

*Përsëri vërtetohet fakti se **INFORMIMI** është problemi më i madh në marrëdhëniet mes qytetarëve dhe Qeverisjes vendore (përpara dhe pas organizimit të takimeve publike).*

11 Në çfarë mënyre preferoni që Pushteti Lokal t'ju informojë për çështjet me rëndësi për komunitetin tonë?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Përmes mediave lokale	49
Broshurat, buletinet, informatorët	24
Përmes Internetit (web faqet e Komunës, FB)	78
Takimet publike me qytetarë	51
Diçka tjetër *	2
	204



* Përmes zyrtarit të Komunës për marrëdhënie me publikun

* Përmes të gjitha formave të shënuara, qytetari duhet të jetë gjithmonë i informuar


Në pyetjen se si do të dëshironin të informoheshin për ngjarjet me rëndësi në komunitet, një numër i konsiderueshëm qytetarësh kërkon që kjo të bëhet përmes internetit (38%). Megjithatë, nuk janë pak as ata që dëshirojnë që Pushteti lokal të organizojë takime publike me qytetarë, ku do të diskutoheshin tema me rëndësi për komunitetin lokal (25% mendon se duhet të organizohen takime publike).

24% e qytetarëve të anketuar preferon që të informohet përmes mediave lokale, ndërsa 12% e tyre preferojnë të marrin në dorë broshurat, informatorët, buletinet që do t'i publikojë Komuna për informimin e qytetarëve.

Pra 1/4 e qytetarëve preferojnë takime direkte me drejtuesit e Komunës.

- 12 Sipas mendimit tuaj, a është “e drejta e qytetarëve që të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në nivel lokal” e garantuar me ligj apo është çështje që e vendos Qeverisja vendore?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Çështje që e vendos Qeverisja vendore	59
E garantuar me ligj	116
Nuk e di	29
	204



Se nga buron e drejta qytetare për pjesëmarrje në procesin e vendimmarrjes, shumica e qytetarëve mendojnë se kjo e drejtë rrjedhë nga dispozitat ligjore, pra është e garantuar me ligj.


Për dallim nga këto 57% të qytetarëve, të cilët janë të sigurt se kjo e drejtë iu garantohet me ligj, 29% konsiderojnë se kjo e drejtë mund të realizohet vetëm nëse lejon Pushteti lokal, pra, mendojnë se është çështje që e vendos vetëqeverisja lokale.

Nga të gjithë të anketuarit, 14% e tyre nuk dinë dhe nuk mund të përcaktohen se si është e rregulluar e drejta e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes, në nivel lokal.

Shumica e qytetarëve e di se e drejta e qytetarëve për pjesëmarrje në vendimmarrje është e garantuar me ligj, por gjithashtu janë të vetëdijshëm se kjo në masë të madhe varet nga vendimet e pushtetit lokal.

13 Cilat janë prioritetet më të rëndësishme, me të cilat Qeverisja vendore dhe Kryetari i Komunës, duhet të merren në periudhën e ardhshme?

përgjigjet e qytetarëve	të anketuar
Problemet lokale ekonomike (krijimi i kushteve për punësim)	54
Infrastruktura (rrugët, ndriçimi, rregullimi i qytetit,)	24
Problemet komunale (parkingjet, komunikacioni, tregu, plehrat)	31
Ujësjetllësi, kanalizimi, mbrojtja e ambientit	19
Problemet e të rinjve	41
Avancimi i bujqësisë (zhvillimi i zonave rurale)	23
Jeta kulturore e qytetit	12
Diçka tjetër	0
	204



Që kriza ekonomike ka filluar të ndikojë dukshëm në standardin e jetesës së popullatës lokale, tregon edhe përgjigja më e shpeshtë e qytetarëve të anketuar (27%) për prioritetet e Komunës, të cilët kanë veçuar pikërisht zgjidhjen e problemeve ekonomike të qytetit e që kryesisht kanë të bëjnë me hapjen e vendeve të reja të punës. Ngushtë i lidhur me këtë dukuri, qëndron edhe fakti se 20% e qytetarëve është e brengosur për problemet e të rinjve, të cilët shpesh identifikohen me gjendjen e papunësisë, kështu që këto dy përgjigje e plotësojnë njëra tjetrën.

Prioritet për qytetarët janë edhe fushat tjera të jetës shoqërore. Kështu psh. 15% e të anketuarve për prioritet thekson problemet komunale (*parkingjet, komunikacioni, tregu, plehrat*) të cilët gjithnjë e më shumë po bëhen të dukshëm; pastaj problemeve të infrastrukturës (*rrugët, ndriçimi, rregullimi i qytetit,...*) me të cilët qytetarët ndeshen çdo ditë (12%), ndërsa zhvillimin e bujqësisë e vënë për prioritet 11% e qytetarëve.

9% e të anketuarve kërkon një kujdes më të madh për problemet e ujësjetllësit, kanalizimit dhe mbrojtjes së mjedisit, ndërsa një numër më i vogël i qytetarëve favorizon problemet e jetës kulturore të qytetit (6%).

Ekonomia e qytetit, infrastruktura, punësimi, problemet e të rinjve, kultura, ... janë problemet më të theksuara të cilat do të qëndrojnë përpara Kryetarit të ri të Komunës dhe ekipit të tij.

Padyshim që, nga mënyra e qasjes dhe e zgjidhjes së këtyre problemeve, qytetarët do të vlerësojnë edhe punën e tyre.

Rekomandime për përmirësimin e pjesëmarrjes qytetare

Nëse pjesëmarrjen qytetare e shikojmë si marrëdhënie partneriteti të qytetarëve dhe organeve të vetëqeverisjes lokale, atëherë është e qartë se për rritjen e kësaj pjesëmarrjeje janë përgjegjëse të dy palët në këtë raport partneriteti. Rezultatet e hulumtimit të opinionit publik mund të përmbledhen në konstatimin se pjesëmarrja qytetare në komunën e Ulqinit është relativisht e ulët dhe se, as qytetarët e as autoritetet lokale nuk janë në veçanti të motivuar që personalisht të angazhohen për të rritur nivelin e pjesëmarrjes qytetare.

INFORMIMI I QYTETARËVE PËR PUNËN E VETËQEVERISJES LOKALE

Informimi i qytetarëve për punën cilësore të vetëqeverisjes lokale, është faktor i rëndësishëm motivues i cili mund të zvogëlojë paragjykimet e mundshme të qytetarëve. Atyre në këtë mënyrë iu bëhet i afërt mekanizmi i qeverisjes dhe iu rritet ndjenja e kompetencës që ata mund të ndikojnë në vendimet e Pushtetit lokal.

Pushteti lokal mund të jetë i hapur për bashkëpunim dhe mirë i organizuar, por ndodhë që qytetarët të mos kenë besim në te dhe të kenë përshtypje krejt të kundërt. Ky imazh, pa marrë parasysh se është i gabuar, i pengon qytetarët për pjesëmarrje aktive në proceset vendimmarrëse. Për këtë lloj situatë përgjegjësia mbetet tek Pushteti lokal.

Prandaj edhe është e rëndësishme që Pushteti lokal të praktikoj një politikë proaktive në komunikim me qytetarët dhe të këmbëngulë që informacionet të mbërrijnë tek qytetarët. Pushteti duhet t'i njoftojë qytetarët me aktivitetet e veta, me planifikimet dhe arsyetimet e vendimeve që merren.

Përmirësimi i informimit është në kompetencë të vetëqeverisjes lokale. Në procesin e informimit aktiv, pushteti lokal ka në dispozicion forma dhe kanale të shumta për dërgimin e informacionit te publiku i gjerë. Disa nga këto forma të informimit mund të jenë:

- **Broshurat** – të cilat në mënyrë të qartë e të kuptueshme përshkruajnë strukturën e Vetëqeverisjes lokale dhe aktivitetet e saj, por edhe format se si qytetarët mund të participojnë;
- **Tabela e shpalljeve** në Komunë – do të përmbante informacione siç janë: thirrjet publike, propozimet e rendit të ditës, aktivitetet aktuale dhe të planifikuara, etj.
- **Shërbimi telefonik** – përmes të cilit qytetarët mund të informohen për çështje të caktuara
- **Faqet funksionale në internet** të Komunës së Ulqinit
- **Lajmërimi përmes mediave** – informim për aktivitete përmes konferencave për media
- **QENDRA PËR INFORMIMIN E QYTETARËVE** – në rastin më të thjeshtë, kjo do të ishte një hapësirë e veçantë në të cilën qytetarët e interesuar do të gjenin dhe të lexonin apo të fotokopjonin vendimet dhe rregulloret komunale, por edhe publikime tjera që iu nevojiten.

ORGANIZIMI I KONSULTIMEVE ME QYTETARË

Për dallim nga informimi, konsultimi është lloj i komunikimit të dyanshëm në mes të pushtetit dhe qytetarëve. Si rregull, qytetarët kanë mundësi të kërkojnë informacione relevante, por edhe të paraqesin mendimet, propozimet dhe vërejtjet e tyre. Pushteti lokal duhet të ofrojë informacion dhe të interesohet për mendimet dhe qëndrimet e qytetarëve.

Ka mënyra të shumta se si mund të organizohen konsultimet:

- **organizimi i ekipeve** të cilët do të bisedojnë me qytetarë
- **organizimi i “dyerve të hapura”** (*me shërbimet e Komunës, këshillat e Kuvendit, etj*)
- **organizimi i takimeve publike** (*shqyrtimeve, debateve, grupe të fokusit*)
- **kutia për propozimet dhe ankesat e qytetarëve**
- **hulumtimi i opinionit publik** përmes anketave dhe intervistave

BASHKËPUNIMI MË I MADH I ORGANIZATAVE JOQEVERITARE ME PUSHTETIN LOKAL

Në Komunën e Ulqinit gjithsesi duhet të ndryshohet raporti ndaj organizatave joqeveritare, në mënyrë që ata të mos konsiderohen si kundërshtar të pushtetit. Imazhi më real ndaj OJQ-ve nuk duhet të dalë vetëm nga fushatat propaganduese, por para së gjithash, nga ndërtimi i raporteve të partneritetit në mes organizatave joqeveritare dhe Komunës për zgjidhjen e problemeve lokale.

Hulumtimet tregojnë se ekziston një mosbesim i theksuar i autoriteteve lokale ndaj organizatave të shoqërisë civile. Prandaj, *është e nevojshme që të vendoset bashkëpunim i ndërsjellët për përgatitjen, aprovimin dhe zbatimin e vendimeve të ndryshme strategjike; hartimin e politikave publike, vendimeve dhe rregulloreve lokale, duke ndikuar në këtë mënyrë në rritjen e participimit qytetar.*

Përfaqësuesit e OJQ-ve lokale mund të marrin pjesë në punimet e trupave të Kuvendit të Komunës dhe në këtë mënyrë të jenë drejtpërsëdrejti të inkuadruar në njërin prej fazave më të rëndësishme të punës së Parlamentit lokal. Këtë mundësi e parasheh Statuti i Komunës së Ulqinit, i cili përcakton se për anëtarë të trupave punuese të Kuvendit, mund të zgjidhen edhe qytetarët ose përfaqësuesit e organizatave joqeveritare.

TRAJNIMI I PËRFAQËSUESVE TË PUSHTETIT LOKAL

Është me rëndësi që përfaqësuesit e pushtetit lokal janë të hapur (receptiv) për idenë e pjesëmarrjes së qytetarëve dhe në përgjithësi, për idenë se detyra e tyre themelore është t'iu ofrojnë qytetarëve shërbime dhe të jenë me ta në marrëdhënie partneriteti. Duhet të ndryshohen një sërë qëndrimesh të zyrtarëve komunal, si psh. *që konsultimi i qytetarëve është proces që kushton dhe është i komplikuar, që qytetarët dhe OJQ-të nuk janë kompetentë të vendosin për çështje të caktuara, etj.*

Në këtë kontekst, **është i nevojshëm organizimi i trajnimeve dhe seminareve për përfaqësuesit e Administratës vendore, sidomos për ata që janë në kontakt të përditshëm me qytetarët, në mënyrë që të përfitojnë shkathtësitë dhe njohuritë e nevojshme.**

SEMINARE EDUKUESE DHE FUSHATA PËR QYTETARË

Ky hulumtim tregon se niveli i informimit dhe i motivimit të qytetarëve është shumë i ulët, kështu që ndër detyrat e rëndësishme është edhe informimi i tyre për të drejtat dhe detyrimet e veçanërisht për mundësitë dhe procedurat e pjesëmarrjes së qytetarëve në procesin e vendimmarrjes. Modeli më i mirë i organizimit të këtyre aktiviteteve gjithsesi është kur këto realizohen në partneritet Komuna me OJQ-të lokale.

PROMOVIMI I VLERAVE TË PJESËMARRJES QYTETARE

Në komunitetin tonë lokal nuk njihen sa duhet dhe nuk shpërblehen qytetarët me meritë për veprimtari në shoqërinë civile. Termet *'organizata të shoqërisë civile'* dhe *'qytetaria aktive'* kanë filluar të përdoren jo shumë kohë më parë, në proceset e veprimit qytetar.

Shpërblimet dhe mirënjohjet i bëjnë më të dukshëm këto veprime në shoqëri. Ka mundësi për shembull, që të ndahet shpërblimi për bashkësinë lokale apo OJQ-në më të suksesshme ose shpërblimi për kontributin e individëve të cilët me angazhimin e tyre kanë dhënë kontribut të çmueshëm në komunitetin lokal.

RIAKTIVIZIMI DHE RIORGANIZIMI I BASHKËSIVE LOKALE

Ringjallja e aktiviteteve në bashkësitë lokale ka një rëndësi të veçantë për një komunitet lokal të shpërndarë e të gjerë siç është komuna e Ulqinit. Bashkësitë lokale janë hallkë e rëndësishme në afrimin e vetëqeverisjes lokale tek qytetarët, sidomos tek ata të cilët jetojnë në zonat rurale. Bashkësitë lokale janë kornizë për pjesëmarrjen aktive të qytetarëve, të cilët përmes tyre organizohen për të zgjidhur nevojat dhe problemet të cilat qeverisja lokale shpesh i anashkalon. Kështu që, **Komuna e Ulqinit duhet që sa më parë të bëjë rikonstituimin dhe organizimin e bashkësive lokale.**

KËSHILLI PËR MBROJTJEN DHE ZHVILLIMIN E VETËQEVERISJES LOKALE

Është i konceptuar si "forum" i cili duhet të kontribuojë në realizimin e ndikimit të qytetarëve në përmirësimin e funksionimit të vetëqeverisjes lokale. Pra, ky këshill është një **trup i cili formulon propozime për punën më të mirë të organeve komunale dhe një mekanizëm për ndikimin e qytetarëve në zhvillimin dhe mbrojtjen e vetëqeverisjes lokale.**

Formimi i këtij trupi duhet të jetë në listën e prioritetëve të Komunës së Ulqinit.